



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E MBIKËQYRJES NË FUSHËN E DREJTËSISË PENALE DHE
SIGURISË PUBLIKE

Nr. 252/2 prot.

Tiranë, më 02.02.2026

Lënda: Për projektudhëzimet e përbashkëta

MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME

Tiranë

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Zyra e Komisionerit”) ka administruar shkresën tuaj me nr. 5242/5 prot., datë 21.01.2026, protokolluar me tonën me nr. 252 prot., datë 23.01.2026, me anë të së cilës dërgoni për bashkëfirmosje dy projektudhëzimet e përbashkëta të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Ministrit të Punëve të Brendshme.

Nga shqyrtimi i përmbajtjes së projektakteve të ridërguara, Zyra e Komisionerit vlerëson marrjen në konsideratë të sugjerimeve të dhëna nga ana jonë, si dhe angazhimin tuaj dhe të strukturave të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit për përhirjen dhe zbatimin e tyre në të dyja projektudhëzimet respektive.

Në përfundim të procesit të hartimit të projektaktit në zbatim të pikës 3, të nenit 36 të ligjit nr. 82/2024 “Për Policinë e Shtetit”, si dhe pas reflektimit të sugjerimeve tona, vlerësojmë se, projektudhëzimi i përbashkët “Për mënyrën e organizimit, administrimit, afatit të ruajtjes, kontrollit dhe fshirjes së të dhënave të mbledhura në rastet e ndalimit të përkohshëm policor, ndalimit dhe arrestimit të personave”, është në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Lidhur me sa më sipër, bashkëlidhur kësaj shkrese, do të gjeni kopjen e nënshkruar nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, të udhëzimit të përbashkët “Për mënyrën e organizimit, administrimit, afatit të ruajtjes, kontrollit dhe fshirjes së të dhënave të mbledhura në rastet e ndalimit të përkohshëm policor, ndalimit dhe arrestimit të personave”.

Për sa i përket **projektudhëzimit të përbashkët “Për përcaktimin e rregullave, trajtimit, administrimit dhe shpërndarjes së të dhënave personale të mbledhura nga policia”, i**

hartuar në zbatim të pikës 2, të nenit 38 të ligjit nr. 82/2024 “Për Policinë e Shtetit”, vëmë re se sugjerimi ynë mbi përcaktimin e kategorive të të dhënave personale, i dakordësuar edhe me grupin e punës së ngritur nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, nuk është reflektuar sipas argumentimit të dhënë nga Zyra e Komisionerit, me anë të shkresës nr. 3037/1 prot., datë 11.12.2025.

Zyra e Komisionerit, si autoritet përgjegjës për mbikëqyrjen dhe monitorimin e zbatimit të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, ushtron një rol thelbësor në garantimin e përpunimit të ligjshëm të të dhënave personale, me qëllim mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të individëve.

Në këtë kuadër, ju sjellim në vëmendje se, roli i Zyrës së Komisionerit nuk kufizohet në një nënshkrim apo siglim formal të akteve të përbashkëta, por për shkak të rëndësisë së veçantë që ligji i njeh mbrojtjes së të dhënave personale, Komisioneri ngarkohet shprehimisht me kompetencën e bashkëfirmosjes së këtyre akteve me Ministrin e Punëve të Brendshme, pa cenuar në asnjë rast veprimtarinë e Policisë së Shtetit.

Për këtë arsye, vlerësojmë se, me qëllim që ky projektudhëzim të jetë në të njëjtën linjë me legjislacionin në fuqi të mbrojtjes së të dhënave personale, është e domosdoshme që në nenin 5 të projektudhëzimit të përcaktohen kategoritë e të dhënave personale të përpunuara gjatë veprimtarisë policore.

Përmes shkresës që keni dërguar, sqaroni se, përcaktimi i mësipërm është i pamundur dhe tejet kufizues për shkak të natyrës komplekse dhe dinamike të veprimtarisë hetimore dhe operacionale që kryen Policia e Shtetit.

Ndërkohë, nga shqyrtimi i këtij neni, rezulton se janë parashikuar vetëm të dhënat personale të cilat përpunohen në zbatim të nenit 36 të ligjit nr. 82/2024 “Për Policinë e Shtetit”.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, referimi aktual, është i kufizuar dhe i përqendruar vetëm në disa kategori të dhënash personale të përpunuara, duke parashikuar vetëm të dhënat e mbledhura gjatë procesit të ndalimit të përkohshëm policor, ndalimit, dhe arrestimit të personit (*për të cilin është hartuar dhe nënshkruar projektudhëzimi përkatës*).

Në vijim, duke qenë se veprimtaria policore, sikurse ju citoni, është e gjerë dhe dinamike, sugjerojmë që, referuar edhe kompetencave ligjore që ushtrohen aktualisht nga Policia e Shtetit, të parashikohen në mënyrë gjithëpërfshirëse kategoritë e të dhënave personale që përpunohen për qëllime policore, jo vetëm ato të përcaktuara në nenin 36 të ligjit nr. 82/2024 “Për Policinë e Shtetit”.

Në kuptim të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, vlerësojmë që, duhet të përcaktohen kategoritë e të dhënave personale që do të përpunohen e që janë të nevojshme për përmbushjen e detyrimeve ligjore nga ana e Policisë së Shtetit. Bazuar në pikat 2 dhe 3, të nenit 6 të ligjit nr.124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, përcaktimi i

kategorive specifike të të dhënave personale duhet të realizohet në harmoni me parimin e përpunimit në përputhje me qëllimin dhe parimin e minimizimit të të dhënave, sipas të cilave të dhënat personale mblidhen për një qëllim specifik e të ligjshëm, si dhe të kufizuara në masën që është e nevojshme për realizimin e qëllimit.

Duke qenë se respektimi i parimeve dhe standardeve më të larta të mbrojtjes së të dhënave personale përbën një detyrim thelbësor, do të vlerësonim marrjen në konsideratë nga ana juaj të sugjerimit të mësipërm, në mënyrë që projektudhëzimi i përbashkët të vlerësohet i hartuar në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe të vijohet me bashkëfirmosjen e tij.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi